



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

R E N D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;
3. Marrja e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit
4. Të ndryshme

Selim Pacolli nënkyretar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Pika e parë e Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua nga të pranishmi të KKSBB-së.

Pika e dytë e rendit të ditës, Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Prishtinë nga P.K. në këtë pikë të rendit të ditës raportuan tre Komandantet e Stacioneve të Policisë.

Isak Ejupi komandant i stacionit policor të veriut i njoftoj të pranishmit se kanë zhvilluar një analizë për siguri dhe ka dalë se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile, ka një rënie te veprave penale , por gjithsesi jemi duke vazhduar me aktivitete operative dhe po ka rezultate të mira . Jemi duke punuar me dy plane ne shkolla jemi duke mbajtur ligjërata ne shkolla për vedisimin e nxënësve me teme stop droga ne shkolla e kemi mbajtur në 33 shkolla ku janë përfshirë 1900 nxënës dhe plani tjetër ka qenë edhe moto thuaj jo dhunës ne familje dhe i kemi nxitur qe te raportojnë dhunën se vetëm në kete mënyre ne si polici mund ti ndihmojmë qytetaret Vlen te përmendet edhe angazhimi i policisë ne baza ditore për mbajtjen e rendit dhe qetësisë ne institucionet shkollore . Në muajt e fundit kemi pasur grabitje dhe vjedhje të rënda te cilat kane përfunduar me fatalitet , vetëm ne muajin nëntor ka pas 180 raste të vjedhjeve të renda .Ne fund te gjithëve ju uroje një vit te mbarë dhe angazhime dhe suksese në punë.

Faton Shala Shef i operatives së stacionit policor -Qendra i përshëndeti te pranishmit dhe i njoftojë se në rajonin ku ne operojmë ka pasur ka pasur angazhime të shumta ,ankesa nga qytetarët për prishjen e rendit nga lokalet natës sidomos ne fund te këtij viti. Edhe ne si stacionet tjera policore kemi pasur planet operative si stop drogës dhe thuaj jo dhunës ne familje duke ju drejtuar qytetareve për raportim të rasteve te tillë . Ditëve te fundit kemi pasur grabitje dhe vjedhje te renda 70% te rasteve janë ne qendër sepse këtu janë institucionet kryesore. Kërkojë bashkëpunim me institucionet komunale përkatëse sepse tanë ne fund te vittit ne sheshe po ka shume aktivitet si vendosja e tendave për aktivitete dhe nëse lëshohet leje mundësishë ta kemi edhe ne kopje te lejeve te bashkëveprojmë . Sa i përket punës se

Faqe 1 nga 6

lokaleve ne orët e vona po arrijmë qëllimin për te iniciuar lendet ne gjykatë për prishje te rendit por pastaj procedurat po janë te stërgjata

Selim Pacolli nën kryetarë i Komunës sa i përket zhurmës se lokaleve jemi duke biseduar edhe me biznese ta gjemë një zgjidhje të favorshme, gjithashtu i njoftojte te pranishmit me anëtaret e ri te KKSB-së: Belkize Cakolli-Bashkësia Protestante ; Sevdije Rama komuniteti goran ; Besa Halimi-Krasniqi përfaqësuese e këshillit të Prindërve të cilët do ta kenë përkrahjen tonë të plotë.

Hetem Kupina ne cilësinë e kryesuesit te KLSP desha te përshëndes dhe te falënderojë policinë e Kosovës se zonës se veriut ku edhe ne nivel vendi policia ka dal institucion shume i besueshëm për qytetaret .

Besa Halimi-Krasniqi përfaqësues e këshillit te prindërve ne nivel komunal po filloj me ligjératat e mbajtura nga policia e Kosovës të cilat janë shume të nevojshme dhe te të cilat mund te ndikojnë ne përmirësimin e gjendjes se vedi simit te tyre për dukurit negative përdorimi i drogës etj, propozojte te behet një platforme te përbashkët veprimi me Drejtoren e arsimit sepse prindërit po janë te fundit qe po marrin vesh për fëmijët e tyre te cilët janë përdorues droge .

Pika e trete Marrja e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit gjatë festave të fundit

Isak Ejupi komandant i stacionit policor të veriut mbajmë statistikat e të cilat janë ne njësitin antideroje, sidoqoftë ne i kemi përzgjedhur temat qe janë me prioritet për shoqërinë për familje dhe duhet ta kemi edhe pasqyrën familjare se çka i ka shti këta te rijnë te marrin droge ekzistojnë shkaqe familjare sociale. Do ta ndërtojmë një plan për vitin pasues .Ligjératat kane pas efekt te prindërit dhe fëmijët që të fillojmë nga baza zakonisht ka raste që fëmijët me probleme familjare janë përdorues te substancave narkotike si pasojë vine nga mungesa e kujdestarit apo prindërit.

Isak Demiri FSK ju urojë formimin e ushtrisë gjithë të pranishmeve dhe se i përket pikës për përdorimin mjeteve piroteknike do te kyçem me vonë.

Ilmi Vitija përfaqësues i KLSP-Hajvali tha se kemi bashkëpunim të mirë me policinë . Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve për stinën e dimrit duhet të punojmë me ato kapacitete që kemi .

Ilmi Uka - KLSB Keqekollë tha se është i kënaqur me raportet e polisë ne si pjesë civile japim kontributin tone duke i adresuar kërkesat dhe hallet qytetareve por punojmë edhe për zvogëlimin e krimit ,gjendja e sigurisë kryesisht është e mirë, si problem qe kërkon zgjidhje te ne është transporti i udhëtareve disa herë edhe në kete këshill e kam paraqitur por ende s'ka zgjidhje edhe pse kemi marre premtim .

Safet Kamberaj KLSB Dardani tha se sa i përket bashkëpunimit me polici është i shkëlqyer ne kemi bere pune te mëdha se bashku rrëth çështjes së sigurisë me projektet te ndryshme ne kete pjese.

Pika e trete Marrja e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit

Isak Demiri përfaqësuese i FSK-së tha ka mbajtur ligjérata në disa shkolla te Prishtinës "Sami Frashri "Kelmendi", Anton Zako Çajupi për vedi simin e te rinj- eve lidhur rrezikun e mjeteve të pashpërthyera.FSK në bashkëpunim me drejtoren e arsimit ka planifikuar ligjératë neper shkolla lidhur me mjetet e pashpërthyera-minat dhe me policinë e Kosovës do te jemi me afër nxënësve për te vediuar ata.

Hetem Kupina KLSP Bardhosh tha se vërtet duhet te jemi te përkushtuar për këtë atëherë duhet të gjitha hallka e pushtetit të bashkëpunojmë me Drejtoren e arsimit përfaqësues të Komunës ,Policisë ,përfaqësuesit fetar .

Jonuz Salihaj Drejtor i Drejtorisë se arsimit tha se është shume e nevojshme bashkëpunimi me te gjithë akteret e sigurisë FSK- në, Policinë KLSP , përfaqësuesit e shkollave kemi mbajtur trajnim në Bardhosh për mjetet e pashpërthyera duke kontrolluar terrenin me mjete përkatëse dhe të kemi njojurit elementare për këtë lëmi.

Besa Halimi-Krasniqi përfaqësues e këshillit te prindërve në nivel komunal jemi dëshmitarë që në shkollat tona nuk është gjendja e mirë edhe sa i përket sigurisë dhe e përkrahi iniciativën për bashkëpunim me policinë me prindërit siç u përmend ligjëratat për vedisim te nxënësve tanë janë efikase, për pasojat që kane përdorimi i drogës në shkolla tona .

Lulzim Shehu -përfaqësues i fesë se tarikateve i dëgjova raportet e policisë , tha se fëmijët tanë rrinë në telefon internet dhe aty janë te trendë me kohen dhe se policia duhet ti përshtat kohës sepse po me duken këto forma te kaluara dhe klasike , duhet te efektet e duhura te fëmijët tanë me forma të reja te informimit.

Gani Berisha komandant i stacionit policor -jugu, ku e kemi hartuar planin për veprim ne kemi marre parasysh edhe masat e detyrueshme të cilat janë shumë me efikase sepse në internet ata lexojnë çfarë të duan vet e jo ajo që është në të mirë të tyre .

Besa Halimi-Krasniqi tha se është mire qe edhe me metoda te reja te hyn si siç janë video ne internet te jene si forme detyre për ti kryer ne shtëpi përmes internetit duke bashkëpunuar me arsimtar neper shkollë te jene me te kapshme për fëmijët tanë.

Jonuz Salihaj me fillimin e vitit shkollor Ministria Arsimit përmes një Udhëzim administrativ te nxjerre e ka dërguar nëpër shkolla ku nuk ju lejohet marrja dhe përdorimi i telefonave ne institucionet shkollore duke parapare edhe masa ndëshkuese Të behën reklamime ne faqet e internetit për ngritjen e ve dijes të rindjeve për pasojat e drogës dhe dukurive tjera negative dhe se parandalimi pamarre parasysh me çfarë metoda sensibilizimi i masës se gjere te popullsisë , siç ishte mbajtja e ligjëratës nga policia me 2000 nxënës është një mostër e mire për ta marre hapat tjerë.

Isak Ejupi komandant i stacionit policor të veriut me një statistike që ka identifikuar policia ku 70% janë mosha shumë të reja, dhe me marrjen e masave ne diskoteka për zbulimin e rasteve te reja kane ndikuar ne mënyrë pozitive për luftimin e kësaj dukurie dhe ata qe kane organizuar kane marre masa ndëshkuese komfor veprave.

Hetem Kupina KLSP Bardhosh- jemi duke biseduar për masat parandaluese për përdorimin e mjeteve piroteknike , te jemi vigjilent dhe ti përmbahemi pikave te rendit te ditës sikur policia qe na referuan për punën ne shkolla, arsimtaret te bëjnë punën e tyre ne qeshjen e sigurisë te jene kapshme dhe te frytshme me rezultate.

Selim Pacilli nënkyrytar i Komunës kërkoi qe ti përmbahemi rendit te ditës

Safet Kamberaj KLSP-Dardani - tha se sa i përket sigurisë nëpër shkolla ngriti çështjen e drejtoreve të shkollave e te cilët janë ushtrues detyre duke filluar pre 6 muaj e deri ne 2-3 vite dhe se as menaxhimi nuk mund te jete efikas dhe se vështirë të bihet gjendja në binarë edhe me nxënësit .

Jonuz Salihaj Drejtor i Drejtorisë se Arsimit ai tha se ne shumicën e shkollave e kemi zgjedh problemin e përzgjedhjes së drejtoreve përmes Këshillit të prindërve OJQ edhe Klan ka qene me një reportazh në shkolla gjate rekrutimit të kandidateve , zgjedhja ka qenë transparente . Në shkollat profesionale është e duhur te jetë fusha përkatëse, pak me vështirësi por jemi duke i zgjedhur .

Ilmi Uka KLSP Keqekolle u interesua rrith planit te ligjëratave për nxënësit e shkollave te Gollakut se a ka plane Ushtria e Kosovës dhe Policia lidhur me mjetet e pashpërthyera në fshatrat e asaj ane .

Selim Pacolli tha se ne vitin e ardhshëm do ta bëjmë një plan veprimi për mjetet e pashpërthyera.

Isak Demiri FSK - ne i kemi planet në bashkëpunim me drejtorinë e Arsimit se ne cilat shkolla do ti mbajmë trajnimet , por në çdo thirrje nga qytetarët jemi te gatshëm për të ndihmuar.

Te Ndryshme

Ilmi Uka sa i përket çështjes se transportit në regjionin e Gollakut po kemi premtimë dhe fjale të mira nga autoritete komunale por kjo kërkesë nuk është duke u realizuar. Nuk është problem magjistralja Keqe kollë -Prishtine ajo po shkon me rregull por e kemi fjalën te fshatrat në thellësi të Gollakut Hajkobillë, Prapashtcë etj .Propozojë qe nga linjat tjera si Bardhosh ose edhe nga qyteti te dërgohen për plotësuar linjën e kërkuar. Edhe me herët kam kërkuar një roje në BL Keqe kollë sepse aty janë vjedhur kompjuterë ,fotokopja dhe gjera tjera të zyrës .

SelimPacolli nënkyetar i Komunës tha Operatoret Privat i kemi referuar linjat rurale por ata si duket nuk po shkojnë sepse nuk po kane llogari financiare ,por në fillim te muajit Janar do ta hartojmë një plan te ri për linjat e trafikut urban. Është një neglizhencë e imja qe nuk kam mundur ti vizitoje vet ato fshatra te Gollakut dhe ti shoh mundësit për t'i ndihmuar, sa i përket pajisjes me inventar ne BL do te kompletohen me materiale të nevojshme .

Xheladin Fazliu përfaqësues i bashkësisë fetare islame dhe KLSP Hajvali tha se kërkojë nga Drejtoria e Arsimit qe te bëjnë rrëthimin e dy shkollave sepse qasja e te tjerëve nuk munde te behet dhe se shkolla fiton imazhin e duhur dhe se ata qe ata nuk janë pjesë e saj nuk munden te qëndrojnë më dhe ta pengojnë procesin mësimor. Me përkrahjen të drejtoreshës se re kemi bere pastrimin e ujerave te zeza në oborrin e Shkollës "Shkëndija". Paraqiti edhe problemin e varrezave qe i është ofruar shtëpive, pastaj depot e mbeturinave te Pallati i Drejtësisë . Objekti i BL-së është shume i mire por jo funksional po me duket se jemi ngutur ne këtë çështje .

Dejan Millutinoviq përfaqësues i komunitetit serb falënderoje Policinë për bashkëpunim te cilët na jepin siguri ne ambientin ku jetojmë . Por paraqiti problemin e ndotjes se lumit Bernicë e Poshtme-Mazgit kur ka te reshura atmosferike mbeturinat dalin në sipërfaqe deri te "Kodra e Trimave, të bëhet pastrimi i lumit .

Safet Kamberi KLSP -Dardani paraqiti disa rreziqe qe ju kanosen qytetareve: Rrezik te rr. "Ilaz Kodra " dy shtylla të rrymës në afërsi te shkollës "Donbosko", Ndriçimin te shkolla bujqësore ; te shkolla "Xhemajl Mustafa" tash e 6 vite kanalizimi po del në sipërfaqe ; Pengesat ne rruge ku një dite është lënduar një grua ; Qendra tregtare afër postes me mbi 200 lokale janë të mbushura me ujë ; Pllatoja te kurrizi ku ka kallëzim penal ; Impianti për lagjen e Emshirit paraqet rrezik të madh te kompleksi mbi urë paraqesin rrezik të madh gypat që janë vendosur dikush duhet dhënë përgjegjësi për këtë.

Violeta Hasani KLSP -Qendra te cilën e përfaqësojë unë znjsh. Violeta Hasani fillimi shi ju falënderohem për bashkëpunim me ata te cilët punojmë. Per lagjen Qendra si problem mjaft shqetësues mbetet problemi i zhurmave te kafiterive te cilat organizojnë muzikë (live) te gjallë duke u pamundësuar banoreve te atyshëm te jetojnë një jete normale madje as ne raste vdekje ata nuk ndalin muzikën. Gjatë vitit 2018 për çdo muaj kemi realizuar takimet me qytetare , ju lutem komunës që të ju dilet në ndihmë sepse është bërë problem serioz sipas te pranishmeve 3 kafi tërit janë te zhurmshme te cilat i kemi cekur edhe në takimet e mëparshme . Shqetësim tjetër kemi parkingun e Lagjes ne rrugën "Nuri Zeka " tek tuneli ku gjendet biznesi "Trosha" është e pamundur për ndonjë rast te vije ndihma e shpejt apo zjarrfikësit, është e bllokuar tërë javën nga banoret jo rezident, kërkohet vendosja e një laure (ramp) apo te ju behet një zgjidhje nga ana e komunës sirenat e automjeteve tere ditën nuk ndalen .Si përfaqësuese e KLSP kam dëgjuar nga disa banore qe janë mbledhur disa nënshkrime qe është manipuluar me emrin tim nga kafi teria

Faqe 4 nga 6

"LuluBare" e cila nuk e ka te drejtën e mbledhjes se nënshkrimeve sepse nuk janë banore te asaj lagje e aq me pak te merren me për ti mashtruar banoret e atyshëm, por kete punë e kam lenë në duart e Policisë të Stacionit Qendra dhe Komunës. Dua të falënderoje në emër të Komitetit Lokal për Siguri Publike KLSP-Qendra ne emër te shumicës se banoreve dhe ne emrin tim personal juve z. nënkyrytar z.Selim Pacolli, Policinë e stacionit Qendra me te cilët kemi një bashkëpunim shume te mirë në identifikimin dhe adresimin e shqetësimeve të qytetareve në shumicën e rasteve edhe të zgjidhjes së tyre nga ana e Komunës dhe Policisë .

Fatmir Bilalli i njoftoj se ne bazë te kërkesë se qytetarëve ne një strehimore te qyteti kemi larguar dhe de minuar ne bashkëpunim me FSK brenda saj ne kemi gjetur një granate dore . Pastaj informoj se është realizuar kërkesa e komuniteti ashkali ne odren me pajisje të kontejnerëve të mbeturinave e cila kërkesa është bere nga përfaqësuesja e zyrës se komunitetit- për komunitet Klaudia Gegaj -Mula.

Hetem Kupina qe 7 vitet e fundit e para here qe janë mbajtur 6 mbledhje të rregullta te KKSBB-së pra siç kane qenë të parapara me Udhëzim Administrativ .Prandaj kryesuesit të KKSBB-së z.Selim Pacolli si dhe koordinatorit Fatmir Bilalli ju takon një falënderim për punën e kryer si është me së miri. Gjithashtu policia e ka kryer detyrën e vet në nivelin me të larte dhe ka qene shume transparente .Edhe KLSP kane qenë në nivel të duhur kanë kryer punën e vet me përgjegjësi . Gjithashtu një merite te madhe i takon edhe shefit te SHP Habib Qorri për punën e kryer dhe për bashkëpunim me strukturat kommunale .

Don Kastrioti Krasniqi falënderojë policinë dhe komunën për bashkëpunim të shkëlqyer , prandaj ne jemi për të ndihmuar njeri -tjetrin .Kisha katolike qe 20 vite ka ndihmuar shumë te rinjtë që kanë qene përdorues të drogës ku përmes kishës ne Ulpianë kane mbajtur takime me familjaret e personave që janë përdorues të drogës dhe përmes tyre Kisha i ka dërguar në Kroaci për rehabilitim personat e varure dhe kemi pasur rezultate shumë te mira , ku te rinjtë tanë janë kthyer te shëruar nga dukuri shkatërruese dhe janë këqyr në pune dhe janë bërë pjese e dobishme e shoqërisë . Jemi në prag të festes së krishtlindjeve i hapim dyert për të gjithë ju ftojë të merrni pjesë ne ritualet tona jeni te mirëseardhur .Pati një kërkesë për largimin e kontejnerëve nga kisha sepse po na pengojnë .Gjithashtu e çmojë lartë patrullimin e policisë me rroba civile gjatë manifestimeve tona .

**Procesmbajtësja
KKSB-s**

Hateme Gashi

Kryesuesi i Mbledhjes së

Shpend Ahmeti

